

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët, Tonka Berishaj, kryetare, Have Haliti dhe Fillim Skoro anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit P.H., për shkak të veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, këmbimi, prodhimi, ndërmjetësimi, shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par. 1 të KPK-së, dhe kundër të akuzuarit A.H., për shkak të veprës penale ndihmë importi, eksporti, furnizimi, transportimi, këmbimi, prodhimi, ndërmjetësimi, shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par. 1 të KPK-së, lidhur me nenin 33 par. 2 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit P.H., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.255/13, të datës 19.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, më datë 08.11.2018, mori këtë :

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit P.H., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.255/13, i datës 19.09.2018, vërtetohet.

II. Aktgjykimi, përkitazi me të akuzuarin A.H. ngel i pa prekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.255/13, të datës 19.09.2018, i akuzuari P.H., është shpallur fajtor për veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, këmbimi, prodhimi, ndërmjetësimi, shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par. 1 të KPK-së, dhe është dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) €, të cilin dënim i akuzuari duhet ta përmbush në dy këste, në afat prej 15 muajsh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën ky dënim do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një natë burgim vlen 20 €, si dhe dënim me kusht në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda periudhës kohore prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër tjetër penale. Ndërsa i akuzuari A.H., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndihmë importi, eksporti, furnizimi, transportimi, këmbimi, prodhimi, ndërmjetësimi, shitja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par. 1 të KPK-së, lidhur me nenin 33 par. 2 të KPK-së, dhe është dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim, i akuzuari duhet ta përmbush pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën ky dënim do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një natë burgim vlen 20 €, si dhe dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda periudhës prej kohore prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit janë obliguar të që paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, secili veç e veç të paguajnë nga 30 (tridhjetë) €, brenda afatit prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër aktgjykimit në afat ligjor ankesë ka paraqitur.

I akuzuari P.H., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ashtu që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe ti shqiptoj dënim minimal me gjobë.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/L.nr.496/18, të datës 29.10.2018, ka propozuar të te refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit P.H., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konformë nenit 390 par. 1 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit, për të cilën nuk u njoftuan Prokurori i Apelit dhe i akuzuari, meqenëse të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënim me burgim.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit pas vlerësimit edhe të shkresave tjera në lëndë, gjeti se:

Ankesa e të akuzuarit, P.H. është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar prishjen e aktgjykimit dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, se me ankesë nuk mund të kontestohet konform nenit 383 par. 2 të KPPK-së, se i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë, kryetari i trupit gjykues është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësoj vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore përkitazi me vendimin mbi dënimin.

I akuzuari në ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është tejet i lartë, duke pasur parasysh se në seancën fillestare e ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje dhe pendim të thellë për kryerjen e veprës penale, duke premtuar se asnjëherë më nuk do të kryej vepër penale, se ka qenë i ri në kohën e kryerjes së veprës penale dhe i gjendjes së dobët ekonomike, se tani është baba i dy fëmijëve dhe i pa punë, mbajtës i familjes së dënimi me gjobë në shumë prej 800 €, do ta rrezikoj ekzistencën e familjes së tij, se sikur gjykata e shkallës së parë ti kishte vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat e lartcekura lehtësuese, do ti shqiptonte dënim më të butë, konsideron se vendimi mbi dënimin i shqiptuar është i padrejtë dhe i paqëndrueshëm, tejet i lartë dhe jo i bazuar sa duhet në ligj, si dhe në kundërshtim me të drejtën materiale.

Kjo gjykatë gjen se, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e

dënimit, si rrethanë lehtësuese gjen pranimin e fajësisë, pendimin e thellë, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, se është familjar, mbikëqyrës i vetëm i familjes, dhe sjelljen e mirë në të gjitha fazat e procedurës, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk ka gjetur. Duke i pasur parasysh rrethanat personale të akuzuarit si dhe pranimin e fajësisë, me të drejtë ka aplikuar dispozitat e nenit 76 par. 1 të KPK-së, të zbutjes se dënimit dhe i ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë me ligj, i akuzuari nuk thekson asnjë rrethanë konkrete lehtësuese e cila do të ndikonte që dënimi të jetë më i butë nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, prandaj pretendimi i të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër është i pa pabazuar, se gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar dënim me burgim nën minimumin ligjor të paraparë për këtë vepër penale. Vlerësimet e këtylla të gjykatës së shkallës së parë i pranon edhe kjo gjykatë, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.522/18, të dt.08.11.2018

Procesmbajtësja,
Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit

Kryetarja e kolegjit
1. Tonka Berishaj

2. Have Haliti

3. Fillim Skoro